



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL
DREJTORI EKZEKUTIV

Nr. 3184/11 prot.

Tiranë, më 30.12.2025

VENDIM

Nr. 67, datë 30.12.2025

PËR KUFIZIMIN E LICENSAVE TË PILOTËVE

Në mbështetje të pikës 6 të Nenit 70 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 1095, datë 24.12.2020 "Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil", i ndryshuar, për të siguruar zbatimin e Urdhrit të Ministrit Nr. 178, datë 20.12.2023 "Për miratimin e Rregullores për kërkesat Teknike dhe Procedurat administrative në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil", i ndryshuar" si edhe Urdhrit të Ministrit Nr. 218, datë 29.12.2023 "Për Miratimin e Rregullores për përcaktimin e rregullave të detajuara në lidhje me pranimin e certifikatave të pilotëve nga vendet e tjera" në parandalim të cënimeve të mundëshme të sigurisë në operim:

V E N D O S A:

1. Autoriteti i Aviacionit Civil do të kufizojë procesin e Licensimit të pilotëve sipas Pjesës-FCL, të urdhrit të Ministrit Nr. 178, datë 20.12.2023 "Për miratimin e rregullores për përcaktimin e rregullave të detajuara në lidhje me pranimin e certifikatave të pilotëve nga vendet e tjera", i ndryshuar me afat kohor deri më 30.11.2027.
2. AAC në përputhje me rregullat në fuqi do të kryejë funksionet e validimit të licensave të lëshuara nga Autoritetet kompetente të vendeve të tjera sipas Aneksit 1 të ICAO-s si dhe njohjen e licensave të lëshuara nga autoritetet kompetente të vendeve të BE-së, sipas Pjesës-FCL.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Autoriteti i Aviacionit Civil.

DREJTOR EKZEKUTIV
Maksim Et'hemaj

